

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Një milion skedarë, gra të zhdukura dhe video të një gruaje duke u mbytur/ Njihuni me shtëpinë e tmerrit të fotografit. Për krimet e llahtarshme nuk mund të dënohet!
ADRESA	https://piranjat.al/bota/nje-milion-skedare-gra-te-zhdukura-dhe-video-te-nje-gruaje-duke-u-mbytur-nj-i104889
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 16:39:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 16:31:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	56e157f7f2e184c4bf5c3a3421491ea614ab83cc0bdeb1e1470d2c72dae61ca6
TEKSTI	d76c2c7fe490b9439d738c9020a802681fa37151847369649c0f14950eff3005
PAMJA	e32e7a618a0530fa70209f916424788268279624f148365efda8ba185f1cb7c9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ddff57e9f29870e1888cb7cb836c2fde93dad32933729cd6c0ec7f09ea0c7dec
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	01dec896a9f5048ec789d11efc6a4c6ac149c2dbc9d9f31c517f24c69c93634b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ddff57e9f29870e1888cb7cb836c2fde93dad32933729cd6c0ec7f09ea0c7dec>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash:

[dyshohet se ka dëmtuar](#)

[Spitalit të Traumës në Tiranë, pasi](#)

[pezullimeve masive të](#)

[nëgarëve që raportinin për protestat në](#)

[reja për marrëdhënien](#)

[se vranës, duke sjellë ndryshime të dukshme](#)

[Durrës, shërbimi](#)


[Rinia në Durrës. Mësohet](#)

[grumbulluarve dhe talenti i Izraelit](#)
[edhe talenti i Pakist](#)

BOTA

Një milion skedarë, gra të zhdukura dhe video të një gruaje duke u mbytur/ Njihuni me shtëpinë e tmerrit të fotografit. Për krimet e llahtarshme nuk mund të dënohet!

Piranjat Përditësimi i fundit 18 Shtator 2026, 18:31



Mbi një milionë skedarë dixhitalë me dhjetëra gra përpara kamerës. Fotografit dhe video në të cilat disa prej tyre shfaqen të plagosura, pa ndjenja ose pa shenja jete. Këto janë gjetjet në një shtëpi në veri të Filadelfias, në SHBA, që i përkiste një fotografi i cili vdiq përpara se autoritetet të kuptonin përmasat e asaj që kishte lënë pas.

Shtëpia në 417 West Chew Avenue ndodhet në lagjen Olney dhe aty jetonin Raymond "R.C." Horsch dhe djali i tij, Eugene. I pari ishte fotograf dhe krijues i materialeve pornografike dhe vdiq në vitin 2025, në moshën 82-vjeçare. Sot, policia dhe FBI po përpiqen të përcaktojnë, mes sasisë së jashtëzakonshme të skedarëve, se cilat nga skenat e dhunshme që ai regjistronte ishin të inskenuara dhe cilat mund të paraqesin krime të vërteta.

Deri më 16 shtator, hetuesit kishin identifikuar 58 gra që shfaqen në materialet e sekuestruara, sipas CBS. Për pesë prej tyre ka shqetësime se mund të kenë vdekur, ndërsa dy të tjera që lidhen me shtëpinë vazhdojnë të jenë të zhdukura. Ndërkohë, FBI kishte përfunduar shqyrtimin e vetëm rreth 30% të materialeve dixhitale.

Arrestimi që i çoi autoritetet te shtëpia

Më 19 qershor 2026, 44-vjeçari Eugene Horsch u arrestua në Filadelfia. Në makinë me të ndodhej një grua, e cila kishte në zotërim një dokument identifikimi të falsifikuar me emrin "Blair Tonzelli", e cila ishte raportuar e zhdukur në vitin 2023. Autoritetet deklaruan gjithashtu se në automjetin e gjetën dy armë dhe një akreditim i falsifikuar i DEA-s (Administrata Amerikane për Luftën kundër Drogës).

Emri i Tonzelli-t ishte ai që i drejtoi hetuesit drejt shtëpisë në West Chew Avenue. Gjatë kontrollit të banesës, policët gjetën më shumë se 20 enë me substanca të panjohura, një fuçi të lidhur me tuba, armë, drogë, pesë urna dhe dhjetëra pajisje elektronike për ruajtjen e të dhënave. Enët me substancat e panjohura u dërguan për analiza laboratorike.

Eugene Horsch

Më vonë, policët gërmuan përreth pronës dhe hoqën disa pjesë të tubacioneve. Burime të njohura me hetimin i thanë CBS Philadelphia se detektivët po kërkonin prova për përdorim të të ashtuquajturës "kremim i lagësht", një proces kimik përmes të cilit mund të shpërbëhen mbetjet njerëzore. Megjithatë, deri më tani, në shtëpi nuk janë gjetur mbetje njerëzore.

600 mijë fotografi dhe 70 mijë video

Në gusht, policia njoftoi se kishte mbledhur më shumë se 600 mijë fotografi, 70 mijë video dhe mbi 10 mijë faqe me tekste, shënime të shkruara me dorë dhe skica nga pajisjet elektronike të gjetura në shtëpi. Në atë kohë, hetuesit kishin arritur të shqyrtonin vetëm 5-7% të materialeve.

Fotografi dhe video me gra të zhdukura

Mes skedarëve të narë u shfaqën dy emra nga rastet e vjetra zhdukës: Gabrielle Amaranto, e cila ishte 22 vjeçe kur u zhduk në vitin 2012 dhe Marihel Frese, 27 vjeçe kur humbi oturmën në vitin

2018, raporton The Philadelphia Inquirer.

Policët gjetën imazhe të dy grave të gjalla brenda shtëpisë, por edhe materiale të mëvonshme në të cilat ato shfaqen pa shenja jete. Trupat e tyre nuk janë gjetur dhe, siç ka bërë të ditur policia, pa trupat mjeku ligjor nuk mund të lëshojë certifikatë vdekjeje dhe as të përcaktojë zyrtarisht shkakun e vdekjes.




Videoja e mbytjes me lidhëse

Më pas, policët gjetën një video e cila, siç raporton New York Post, është një "snuff movie", ku shfaqet Raymond Horsch duke mbytur një grua. Gruaja u identifikua më vonë nga një i afërm i saj si Nicole Amanda Fusaro, e cila ishte 27 vjeçe kur u zhduk nga Kensington në vitin 2018. Burime policore i thanë Philadelphia Inquirer se besojnë se Horsch e vrau atë. Policia kishte njoftuar gjithashtu familjarët e saj për gjetjen. NBC konfirmoi ekzistencën e videos, por raportoi se nuk kishte mundur të konfirmonte identitetin e gruas që shfaqet në të.

Më 16 shtator, zëvendësrejtori i policisë, Frank Vanore, përshkroi publikisht një pjesë të materialit. Sipas policisë, gruaja shfaqet duke konsumuar drogë dhe më pas duke marrë para nga Horsch. Ai e lidh atë në shtrat dhe i vendos një lidhëse plastike rreth qafës. Më pas, gruaja duket se humbet ndjenjat dhe mbetet e palëvizshme, sipas 6abc.com. "Nicole ishte një grua e bukur dhe zemërmirë, e cila meritonte shumë më tepër se ajo që i ndodhi. Ajo do të jetë përgjithmonë e dashur dhe do t'u mungojë familjes dhe miqve të saj", deklaroi kushëriri i saj, Jonathan Halloran-Cohen.

E zhdukura Blair Tonzelli që çoi te hetimi

Deri më tani, zhdukja e Blair Tonzelli, gruas identiteti i falsifikuar i së cilës u gjet në zotërim të bashkudhëtares së Eugene Horsch dhe që në thelb i çoi policët te shtëpia, mbetet e pazbardhur. Tonzelli u zhduk në vitin 2023 dhe, sipas policisë, ishte një nga gratë që kishte lidhje me shtëpinë. Autoritetet nuk kanë bërë të ditur se kanë gjetur në arkivin dixhital materiale që tregojnë se çfarë i ka ndodhur asaj. New York Post ka publikuar gjithashtu dëshminë veçanërisht tronditëse të një shoqeje të Tonzelli-t. Sipas gazetës, e zhdukura e kishte cilësuar Eugene Horsch si "sociopat" dhe kishte thënë se ai fliste për mundësinë e shpërbërjes së mbetjeve njerëzore me substanca kimike.





U zhduk edhe ish-bashkëshortja e fotografit

Ekzistonte edhe një tjetër grua, gjurmët e së cilës të çonin te e njëjta shtëpi shumë kohë përpara se të niste hetimi aktual. Amy McHale, ish-bashkëshortja e Raymond Horsch, u zhduk në vitin 2016. Më 13 qershor të atij viti, ajo i la një mesazh vajzës së saj, duke i thënë se ishte e sigurt dhe se ndodhej në shtëpinë e Horsch në West Chew Avenue. Që prej atëherë, nuk dihet asgjë për fatin e saj.



Shtatë gra

Autoritetet kanë identifikuar materiale me dy gra të tjera, të cilat shfaqen të plagosura, pa ndjenja ose pa shenja jete. Njëra është rreth 25 vjeçe dhe është identifikuar, por familja e saj ka kërkuar që emri të mos bëhet publik. E dyta ende nuk është identifikuar.

© 2017 by The Associated Press. All rights reserved. Reproduction in whole or in part without permission is prohibited.

Tashmë, shtatë gra që janë të zhdukura ose konsiderohen potencialisht të vdekura lidhen me hetimin e shtëpisë. Nicole Fusaro, Gabrielle Amaranto dhe Maribel Frese konsiderohen nga autoritetet si potencialisht të vdekura, ndërsa Blair Tonzelli dhe Amy McHale vazhdojnë të figurojnë zyrtarisht si të zhdukura.



Fotografi Raymond "R.C." Horsch

Personi që qëndron në qendër të shumicës së këtyre materialeve nuk mund të japë më përgjigje. Raymond Horsch vdiq në vitin 2025, në moshën 82-vjeçare. Për dekada me radhë, ai krijonte materiale erotike dhe pornografike, disa prej të cilave përfshinin skenarë veçanërisht të dhunshëm, si mbytje dhe skena vdekjeje.

Sipas Philadelphia Inquirer, ai u afrohej grave që përballeshin me probleme varësie në Kensington, duke u ofruar para dhe drogë që të shfaqeshin në fotografitë dhe filmat e tij. Ai kishte edhe precedentë penalë, ndër të tjera për prodhim droge dhe falsifikim, por nuk ishte akuzuar për asnjë nga krimet e mundshme që po hetohen aktualisht lidhur me gratë që kanë lidhje me shtëpinë.

Natyra e punës së tij është gjithashtu një nga arsyet pse hetimi po rezulton kaq i vështirë. Policia e di se një pjesë e materialeve ishte inskenuar në mënyrë që të dukej e dhunshme dhe reale. Për këtë arsye, hetuesit duhet të shqyrtojnë çdo fotografi dhe çdo video për të përcaktuar se ku përfundon inskenimi dhe ku mund të ketë filluar krimi.


Djali, Eugene Horsch


Ndërkohë, megjithëse arrestimi i Eugene Horsch ishte ai që i çoi policët te shtëpia, deri më tani ai nuk është akuzuar për vdekjen apo zhdukjen e asnjërës prej grave. Ai vazhdon të mbahet në paraburgim për akuzat që lindën pas arrestimit të tij.

Tashmë, pesha kryesore e hetimit është përqendruar te hard disqet që la pas Raymond Horsch, me më shumë se një milion skedarë. Autoritetet po hetojnë pesë gra të shfaqura në materiale, ndërsa dy gra të lidhura me shtëpinë vazhdojnë të jenë të zhdukura. Dhe pavarësisht gërmimeve, kontrolleve të tubacioneve dhe muajve të hetimeve, asnjë trup nuk është gjetur ende në pronë.

/PiranjatNews/

Galeria fotografike ()





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.